



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.15.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E DREJTËSISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni udhëheqës i ekipit dhe Florë Berisha-Kutllovci anëtare e ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	9
4 Qeverisja e mirë.....	21
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	31

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 25/10/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë (MD), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund ti gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se totali i pasurive me vlerë nën 1,000€ i shpalosur në PFV nuk është i saktë pasi që në të nuk janë të përfshira të gjitha pasuritë që janë në posedim të ministrisë. Ministria e Drejtësisë kishte dërguar shkresë MAP-it për t'i integruar këto pasuri në sistemin e-pasuria, por kjo ishte kryer vetëm pjesërisht për shkak të mos funksionimit të mirëfilltë të sistemit e-pasuria. Vlen të theksojmë se menaxhmenti kishte bërë përpjekje edhe gjatë vitit 2018 për ta rregulluar këtë çështje dhe kishte pasur një progres të mirë në këtë drejtim, por nuk është arritur që problemi të zgjidhet në tërësi.

Përveç mangësive të shpalosjes së pasurive, paqartësi kishte edhe me detyrimet kontingjente, të cilat janë prezantuar në vlerë prej 12,031€.

Avokatura Shtetërore nuk posedon një bazë të mirëfilltë të dhënash për të kuptuar saktë dhe drejt informatat e hollësishme për përfaqësime në gjykata, respektivisht shumat e detyrimeve kontingjente të autoriteteve publike që AVSH i përfaqëson, dhe si rezultat i kësaj, vlera e detyrimeve kontingjente e prezantuar në PFV nuk është e saktë dhe e plotë.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MD-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, të modifikuar, si dhe është përgjegjës për zbatimin e kontrolleve të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të, në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK), dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit.

Si pasojë e korrigjimeve në SIMFK, MD ka diskutuar me Thesarin dhe i ka korrigjuar PFV-të me datën 22.02.2019. Megjithatë çështjet e ngritura si theksim i çështjes nuk ka qenë e mundur të korrigjohen.

Prandaj, deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, me përjashtim të rasteve të potencuar tek theksimi i çështjes, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontingjente dhe për ta konfirmuar vlerësimin dhe shpalosjen e saktë të pasurive jokatipale në PFV-të e vitit 2019.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Përkundër faktit se MD ka vendosur kontrole relativisht të mira në raport me obligimet statutores, mos zbatimin me konsistencë të disa kërkesave, ka shkaktuar mangësi në procesin e pagesave, menaxhimin jo të mirë të pasurive, mos respektimin të plotë të procedurave të prokurimit, etj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli duhet të dëshmojnë proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë respektimi i plotë i procedurave të prokurimit, shmangia e vonësive në pagesën e faturave për mallra dhe shërbime, menaxhimi i kontratave, zotimi i mjaftueshëm i mjeteve dhe menaxhimi i pasurive nën 1,000€.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në këtë pjesë shqyrtojmë burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	22,164,917	20,691,230	20,051,297	18,009,002	18,671,373
Granti i Qeverisë -Buxheti	22,084,717	20,471,141	19,951,538	17,977,959	18,167,651
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	50,957	40,424	42	0
Të hyrat vetjake ³	80,200	80,200	0	19,904	51,224
Donacionet e brendshme	0	88,932	59,335	11,097	452,498

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,473,687€ apo rreth 7%. Ky zvogëlim është si pasojë e shkurtimeve buxhetore që janë bërë me Vendime të Qeverisë.

Në vitin 2018, MD ka shpenzuar 20,051,297€ apo 97% të buxhetit final, me një përmirësim prej 1% krahasuar me vitin 2017. Nga kjo mund të konkludojmë se Ministria në përgjithësi buxhetin e kishte shpenzuar në nivel të kënaqshëm dhe brenda limiteve të përcaktuara nga Kuvendi.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Ministrisë të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	22,164,917	20,691,230	20,051,297	18,009,002	18,671,373
Pagat dhe Mëditjet	13,468,849	12,817,374	12,726,640	12,238,865	12,258,365
Mallrat dhe Shërbimet	5,068,899	5,244,380	4,909,616	4,156,386	4,750,087
Shërbimet komunale	1,044,169	1,019,484	1,007,863	1,042,211	968,009
Subvencionet dhe Transferet	1,578,000	695,097	544,950	99,876	9,900
Investimet Kapitale	1,005,000	914,895	862,228	471,664	685,012

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 651,476€ me vendim të Qeverisë. Reduktimi i fondeve ka ndodhur për shkak se Ministria nuk i kishte plotësuar pozitat e lira të planifikuara me buxhet, për oficerë korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK).
- Te Mallrat dhe Shërbimet, buxheti final në raport me atë fillestar ishte rritur për 175,481€, derisa realizimi ishte rreth 93%. Pavarësisht kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara ishte domethënës te kjo kategori, për shkak se 884,908€ kishin mbetur si obligime të papaguara.
- Buxheti për Subvencione dhe Transfere kishte shkurtime buxhetore me Vendim të Qeverisë për 882,903€. Realizimi i buxhetit ishte rreth 78% për arsye se kjo nuk varej nga Ministria, pasi që këto mjete ishin dedikuar për mbështetje financiare të personave të akuzuar nga dhomat e specializuara të gjykatës speciale.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 90,105€. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte rreth 96%, prandaj mund të konkludojmë se kishte një performancë të mirë të shfrytëzimit të buxhetit për këtë vit, krahasuar me vitet e kaluara ku në vazhdimësi ka pasur vështirësi në realizimin e buxhetit te kjo kategori.

Çështja A1⁴ - Mungesa e evidencave për shpenzimet individuale të qendrave të paraburgimit

Gjetja Sipas planifikimit të buxhetit, bërë përmes Sistemit për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit (BDMS), secili nënprogram i SHKK-së i ka të ndara mjetet e planifikuara për shpenzime operative, derisa realizimi i shpenzimeve bëhet në nivel të SHKK-së si program buxhetor, e jo ndarazi sipas nënprogrameve.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtarët përgjegjës nuk kanë mbajtur evidenca për shpenzimet sipas nënprogrameve (qendrave të paraburgimit, qendrave korrektuese etj), siç është bërë planifikimi i buxhetit sipas formularëve të planifikimit të buxhetit (PCF).

Rreziku Mungesa e informatave për nevojën e shpenzimeve operative nga njësitë në kuadër të SHKK-së, e rritë rrezikun për planifikim jo të duhur të buxhetit për vitet pasuese, me mundësinë që buxheti të rezultoj me mungesë apo teprica fondesh në fund të vitit.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha njësitë organizative mbajnë evidenca dhe raporte të sakta në lidhje me shpenzimet e ndodhura në secilën njësi/qendër të paraburgimit, në mënyrë që buxheti të përgatitet dhe shpenzohet sipas planifikimeve fillestare.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MD në vitin 2018 ishin 189,344€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat që realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të gjykatave, të hyrat nga organizimi i provimeve profesionale për jurisprudencë, përmbarues privat, administratorë falimentues, etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	80,200	80,200	189,344	198,284	201,863
Totali	80,200	80,200	189,344	198,284	201,863

Të hyrat e arkëtuara në vitin 2018 ishin 189,344€. Për shkak të natyrës së të hyrave Ministria nuk kushte bërë planifikim për inkasimin e tyre. Me Ligjin e Buxhetit të vitit 2018 janë lejuar të

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

shpenzohen për nevojat e MD-së 80,200€, prej të cilave janë shpenzuar 40,424€. Pjesa tjetër janë transferuar në Buxhetin e Kosovës.

Përveç të hyrave, MD menaxhon edhe depozitat/paratë e të burgosurve të cilat menaxhohen nga SHKK dhe depozitat e sekuestruara të cilat menaxhohen nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar të Kosovës (AAPSK). Vlera totale e depozitave të regjistruara në SIMFK gjatë vitit 2018 ishte 1,759,087€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MD-së, e të cilat ndërlidhen me përcaktimin e koeficientëve të pagave, avancimin dhe aprovimin e shtesave, etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrole efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme. Në këtë kategori ishin shpenzuar 12,726,640€ apo 99% e buxhetit final.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale), në vitin 2018 ishte 6,263,863€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,917,479€, apo rreth 93% e buxhetit për këtë kategori. Ato kanë të bëjnë me furnizime me ushqim për nevojat e të burgosurve, furnizim me material shpenzues, derivate për ngrohje, veshmbathje për stafin korrektues, shërbime komunale (uji, rryma etj. Nga këto shpenzime, ne kemi testuar 81 pagesa me vlerë të përbashkët prej 1,203,473€, dhe gjashtë procedura të prokurimit në vlerë 2,168,798€. Testimet tona kanë rezultuar me disa mangësi në procesin e pagesave.

Çështja A2 - Pagesa e disa faturave në një urdhërpagesë (UOP) të vetme

Gjetja Sistemi i pagesave (SIMFK) kërkon që në çdo urdhërpagesë të shënohet numri i faturës. Po ashtu, sistemi është i dizajnuar që vetëm një faturë të evidentohet në një urdhërpagesë.

Nga 81 pagesa të testuara, ne kemi identifikuar tri raste ku me një urdhërpagesë (UOP) ishin paguar deri 12 fatura. Kjo ka ndodhur në kuadër të SHKK-së, me arsyetimin se kanë shumë punë dhe kjo për ta thjeshtuar procesin e pagesave.

Rreziku Pagesa e më shumë faturave me një urdhër pagesë, nuk është praktikë e mirë dhe për më tepër e rrit rrezikun që fatura të paguhet dy herë, pasi që në sistem të thesarit nuk ka mundësi të verifikohet se cilat fatura janë paguar më shumë se një herë.

Rekomandimi A2 Ministri, për të eliminuar mundësinë e pagesës së dyfishtë të faturave, duhet të forcoj disiplinën financiare të personave përgjegjës dhe të siguroj që me një urdhërpagesë të paguhet vetëm një faturë, në mënyrë që të ketë kontroll të plotë dhe informata të sakta mbi pagesën e faturave.

Çështja B2 - Mangësi në procesimin e pagesave

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Ne kemi identifikuar se në 19 pagesa, me vlerë të përbashkët 321,054€, për të cilat në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja.

Sipas deklarimeve të zyrtarëve të SHKK-së, kjo ka ndodhur për shkak se gjatë vitit 2018 ishin përballur me vështirësi të alokimit të mjeteve me kohë, dhe me probleme në sistemin e thesarit për të realizuar pagesat.

Rreziku Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë kryerjes së pagesave, është shmangie nga kërkesat ligjore dhe mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.

Çështja A3 -Menaxhim jo i mirë i kontratës

Gjetja Me Rregullën dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik përcaktohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit të kontratës, ku thuhet se menaxheri i kontratës duhet të raportoj dhe ta mbikëqyrë kontratën përgjatë gjithë procesit.

Te Kontrata kornizë - Furnizim me mish dhe produkte të mishit, për të cilën procedurat e prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës i kishte bërë Agjencia Qendrore e Prokurimit (pasi në bazë të saj furnizohen edhe disa Institucione tjera të Republikës së Kosovës), menaxheri i kontratës për furnizimet e MD-së, nuk kishte mbajtur evidenca për furnizimet që ishin kryer nga ana e operatorit ekonomik (OE), dhe si rezultat i kësaj nuk kishte përgatitur raport përfundimtar për realizimin e kontratës.

Kjo, për shkakun se të mungesës së njohurive të menaxherit të kontratës rreth obligimeve të tij për përgatitjen e raporteve periodike dhe përfundimtare mbi realizimin e kontratës.

Rreziku Mungesa e raporteve të shkruara në lidhje me furnizimet e kryera dhe menaxhimin e kontratës në përgjithësi, zvogëlojnë sigurinë nëse kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e parapara.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të kenë njohuritë/trajnimet e nevojshme në lidhje me menaxhimin e kontratave, si dhe të bëjnë një monitorim të vazhdueshëm të kontratave që nga momenti i nënshkrimit deri në përfundimin e kontratës në të gjitha elementet e saj.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti Final për Subvencione dhe Transfere ishte 695,097€. Prej tyre, në vitin 2018 ishin shpenzuar 544,950€. Ato kanë të bëjnë me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave potencial të akuzuar nga dhomat e specializuara. Ne kemi testuar tetë pagesa me vlerë të përgjithshme 316,350€ dhe nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për tu raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 914,895€, prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 862,228€ apo rreth 94% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me renovimin e burgjeve, krijimi i hapësirave për trajnime, blerjen e pajisjeve për laboratorin e histopatologjisë, instalimi i kamerave në qendrat e paraburgimit etj. Nga këto shpenzime ne kemi testuar 13 pagesa me vlerë të përbashkët prej 351,592€ dhe gjashtë procedura të prokurimit në vlerë 517,295€. Testimet tona kanë rezultuar me disa mangësi në procesin e pagesave.

Çështja A4 - Ndarje jo e duhur e detyrave të punës

Gjetja Në bazë të Rregullës dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik, përcaktohet se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, nuk mund të marrë pjesë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit, si dhe një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit.

Ne kemi vërejtur se te Kontrata "Furnizim me pajisje për laboratorin e histopatologjisë" me vlerë 23,690€, ishte caktuar menaxher i kontratës i njëjti zyrtar që kishte marrë pjesë në komisionin e vlerësimit të tenderëve. Përveç kësaj, zyrtari që kishte hartuar specifikat teknike kishte marrë pjesë në komisionin për vlerësim të ofertave.

Shkaku i ndodhjes së kësaj është mungesa e monitorimit adekuat të procesit nga departamenti i prokurimit.

Rreziku Ndarja jo e duhur e detyrave përgjatë procesit të prokurimit rrit rrezikun për favorizim të ndonjërit prej operatorëve ekonomik dhe zvogëlon transparencën e procesit.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të vendos kontrollet e duhura në ndarjen e detyrave dhe të eliminoj mundësinë që personat e njëjtë të kryejnë nga disa funksione, sepse të njëjtat mund të rezultojnë me konflikte interesash.

Çështja A5 - Mos ofrimi i garancionit nga OE

Gjetja Sipas kushteve të veçanta të kontratës, të nënshkruar mes OE dhe autoritetit kontraktues, me titull - Instalimi i sistemit sinjalizues me sensorë, në vlerë 14,790€, ishte kërkuar që OE të ofrojë garancion për shërbimet 24 muaj pas përfundimit të instalimit, për të korrigjuar ndonjë nga defektet eventuale të mëvonshme. Po ashtu, tek kontrata me titull Furnizim me pajisje për kontrollin e trazirave, me vlerë 17,777€, ishte kërkuar që OE të ofrojë garancion në lidhje me furnizimet, së paku 12 muaj pas furnizimit.

Ne kemi identifikuar se tek asnjëra nga kontratat e lartpërmendura, nga OE nuk është ofruar garancioni, siç ishte paraparë me kontratë.

Kjo ka ndodhur për shkak të dështimit të kontrolleve të brendshme dhe menaxhimit jo të mirë të kontratave.

Rreziku Mos ofrimi i garancionit për shërbime/furnizime rritë rrezikun për shpenzime shtesë në rast të shfaqjes së defekteve apo mosfunksionimit të tyre në periudhat e mëvonshme.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj se do të aplikohen kushtet e garancionit të shërbimeve dhe furnizimeve konform kontratave të nënshkruara.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PFV-të e MD-së janë prezantuar 100,406,366€ pasuri kapitale (me vlerë mbi 1,000€) dhe 479,681€ pasuri jo kapitale (me vlerë nën 1,000€). Ministria dhe agjencitë në kuadër të saj kishin bërë një progres në menaxhimin e pasurive me vlerë nën 1,000€, duke e përmirësuar procesin e zhvlerësimit të pasurive, mirëpo edhe më tutje mbetet sfidë regjistrimi i të gjitha pasurive në sistemin e-pasuria. Përveç kësaj, duhet të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurisë. Auditimi ynë, gjatë ekzaminimeve, ka identifikuar çështjet në vijim:

Çështja B3 - Mos harmonizimi i raporteve të inventarizimit të pasurive me të dhënat e programit e-pasuria

Gjetja Sipas rregullës financiare nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Inventarizimi i pasurisë jo financiare duhet të kryhet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe procedurave të brendshme të miratuara nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Në fund të vitit 2018, komisionet e inventarizimit në MD dhe në agjencitë e saj kanë realizuar një proces cilësor të inventarizimit të pasurive, me ç'rast janë identifikuar pasuri të cilat nuk figuronin në regjistrat e sistemit e-pasuria, pastaj një numër të konsiderueshëm të aseteve që nuk kanë barkode, si dhe pasuri të dëmtuara në hapësirat e ministrisë që nuk dihet se kush është i ngarkuar me to. Në SHKK komisioni kishte identifikuar 1262 njësi të pasurisë dhe inventarit që janë jashtë përdorimit dhe të cilat figurojnë ende në regjistrat e pasurive të SHKK-së. Megjithatë raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, dhe me regjistrin nga e-pasuria, për të verifikuar saktësinë e informatave rreth pasurive.

Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të mos funksionimit adekuat të sistemit e-pasuria, pasi që MD ka pasur vështirësi të vazhdueshme në lidhje me këtë, sidomos tek SHKK-ja, si dhe pjesërisht për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të organizatës në këtë fushë.

Rreziku Mungesa e evidencave të sakta në lidhje me pasuritë, rritë rrezikun që pasuritë të humben, keqpërdoren apo përvetësohen. Përveç kësaj, mungesa dhe mos regjistrimi i të dhënave, shkakton raportim jo të saktë të informatave dhe minon kredibilitetin e pasqyrave financiare.

Rekomandimi B3 Ministri të siguroj që çështja e menaxhimit të regjistrave të pasurisë të përmirësohet para mbylljes së vitit aktual fiskal, në mënyrë që në PFV-të e vitit 2019, pasuria të jetë e prezantuar me vlerën e saktë. Si pikënisje duhet të merren raportet e inventarizimit të pasurive për vitin 2018 dhe barazimet me regjistrin kontabël.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 1,243,801€. Këto obligime kanë të bëjnë me mallra e shërbime 884,908€, shpenzime komunale 208,178€ dhe subvencione e transfere 150,715€. Në krahasim me vitin 2017 vërehet një rritje e obligimeve të papaguara për 209,315€. Pjesa më e madhe e obligimeve i takojnë SHKK-së (861,908€ për mallra dhe shërbime si dhe 206,495€ për shpenzime komunale). Shkaku kryesor për mbetjen e këtyre obligimeve është mungesa e mjeteve që ka ardhur si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit (shih Çështjen 1A më lartë në këtë raport). Shkaqet tjera ndërlidhen me vonesën në pagesën e faturave, dhe vështirësive tjera në procedimin e pagesave, të ngjashme si alokimi me vonesë i fondeve, kompletimi i lëndëve etj.

Çështja B4 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr.01/2013 Shpenzimi i Parave Publike (neni 37, paragrafi 1), të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore, duhet të paguhet brenda 30 ditëve, nëse nuk është paraparë ndryshe me kontratë.

Nga lista e obligimeve të shpalosura në PFV-të e vitit 2018, ne kemi testuar 18 mostra, dhe nga testimi ka rezultuar se 14 fatura me vlerë të përbashkët 187,054€ nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor.

Po ashtu nga testimi 81 pagesave për mallra dhe shërbime, të kryera përgjatë vitit, ne kemi vërejtur se në SHKK, 19 fatura me vlerë të përbashkët prej 308,922€ janë paguar pas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh. Vonesat kryesisht janë prej 30 deri në 60 ditë përtej afatit të paraparë ligjor.

Kjo çështje është përsëritur nga vitet paraprake, dhe ka ndodhur për shkaqe të ndryshme, përfshirë mungesën e mjeteve sidomos tek SHKK-ja e cila në vazhdimësi edhe viteve të kaluara kishte pasur mungesë të mjeteve dhe vështirësi tjera në realizimin e pagesave brenda afatit ligjor. Shkak tjetër që ndikon në vonesën e pagesës së faturave në muajt e parë të vitit është vonesa me alokimin e buxhetit.

Rreziku Mos kryerja e obligimeve sipas afateve të parapara me rregulloren e thesarit rritë rrezikun që borxhet të rriten si dhe mundësinë e padive gjyqësore ndaj ministrisë. Kjo mund të shkaktoj edhe çrregullime tjera buxhetore gjatë vitit.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj se të gjitha aktivitetet operative të ministrisë janë të buxhetuara dhe të forcoj disiplinën financiare që të gjitha obligimet e konfirmuara, të kryhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

3.4 Detyrimet Kontingjente

Ministria e Drejtësisë ka prezantuar detyrime kontingjente në PVF vlerën 12,031€. Këto janë pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa që në të ardhmen të krijojnë detyrime financiare për MD-në, varësisht prej vendimeve të gjykatës nëse ato vendosen në favor të palëve paditëse.

Çështja B5 - Menaxhim i dobët i informatave nga Avokatura Shtetërore

Gjetja Konform Standardeve të Kontabilitetit dhe Raportimit, Organizatat Buxhetore janë të obliguara që në PFV, përveç tjerash të shpalosin edhe informata në lidhje me detyrimet kontingjente. Sipas Ligjit Nr.04/L-157, Avokatura Shtetërore është mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i përfaqësimit të pavarur ligjor të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës në procedurat gjyqësore, të arbitrazhit dhe administrative. Rrjedhimisht Avokatura Shtetërore do të duhej që t'i ketë informatat e sakta në lidhje me kontestet dhe paditë ndaj Institucioneve të cilat i përfaqëson.

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur se Avokatura Shtetërore posedon informata në lidhje me të gjitha lëndët ku ka qenë përfaqësues, si dhe data bazën për evidentimin e lëndëve. Megjithatë, këto informata nuk janë sistemuar mjaftueshëm për të shërbyer si bazë krahasuese e detyrimeve kontingjente të shpalosura nga OB-të në PFV. Kjo, ngase përveç evidentimit si raste kontestuese/padi, në regjistrin e lëndëve mungojnë informata të tilla, si: kush është paditësi, kush është i padituri, në cilën fazë gjendet lënda, në shumë raste nuk ka vlerë të përafërt të dëmit/përfitimit të mundshëm etj. Përveç kësaj linjat e komunikimit ndërmjet Avokaturës Shtetërore, Institucioneve që Përfaqësohen dhe Gjykatave, nuk janë shumë funksionale.

Kjo situatë kryesisht paraqitet si pasojë e mungesës së kapaciteteve njerëzore si dhe kushteve tjera dhe hapësirave adekuate për zhvillim të aktiviteteve.

Rreziku Mungesa e informatave të plota rreth rasteve/padive, rritë rrezikun që prezantimi i detyrimeve kontingjente në PVF-të e OB-ve të mos jetë i saktë dhe mos të dihet gjendja reale e lëndëve që janë në procedurë gjyqësore. Përveç kësaj, kjo paraqet menaxhim jo të duhur të informatave nga ana e Avokaturës Shtetërore dhe kufizon fushëveprimin e saj në mbrojtjen e interesit publik.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të konsiderojë mundësinë e rritjes së kapaciteteve njerëzore të Avokaturës Shtetërore dhe përmirësimit të kushteve për punë, si dhe të inicioj një rishikim të funksionimit të data bazës aktuale, për të përcaktuar shkaqet e mosfunksionimit efikas të saj, dhe njëkohësisht duhet të ndërmerren masat e nevojshme që plotësimi dhe menaxhimi i informatave të organizatave buxhetore të përmirësohet.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MD ka shënuar progres në qeverisje, dhe bërë disa përmirësime në sistemet e kontrollit të brendshëm, duke përgatitur regjistrin e rreziqeve, ku janë identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të organizatës, si dhe masat për zbutjen e rreziqeve. Përveç kësaj, MD ka bërë rishikimin e regjistrit të rreziqeve në baza tremujore, si dhe ka trajtuar me kujdes adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm në raportin e auditimit të vitit paraprak. Ndër tjera, janë hartuar procedurat e brendshme për menaxhimin e pasurive dhe rregullorja për paratë e të burgosurve me rastin e lirit nga burgu. Tek menaxhimi i personelit janë zëvendësuar kontratat me akt-emërime etj.

Megjithë progresin, mbeten disa fusha ku nevojiten veprime përmirësuese, sidomos te menaxhimi i regjistrave të pasurive, te procedurat e prokurimit, si dhe te procesi i pagesave për të shmangur vonesat në pagesën e faturave. Po ashtu, edhe tek obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente duhet të shtohet vëmendja. Auditimi i brendshëm duhet ta rrisë fokusin në përmirësimin e kontrolleve të brendshme të organizatës, por kjo duhet të mbështetet edhe me veprime korigjuese nga ana e menaxhmentit.

Ministria ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik (2018-2021), Strategjinë Nacionale të Drejtave Pronësore për vitet 2016-2019, Strategjinë Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Planin e Veprimit 2016-2020. Zbatimi i tyre kërkon kontrolle të brendshme efikase dhe respektim të procedurave ligjore. Prandaj, nevojitet përkushtim më i madh i menaxhmentit për t'i arritur synimet dhe objektivat e përcaktuara.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që

reflekton rreziqet financiare dhe të tjera, të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Për vitin 2018, në bazë të vlerësimit të rrezikut, ishin planifikuar tetë (8) auditime të rregullta, duke i prioritetizuar gjashtë me rrezik të lartë, dhe dy me rrezik të mesëm, si dhe një auditim sipas kërkesës. Ky plan ishte realizuar plotësisht. Aktivitetet audituese kanë mbuluar aktivitetet e vitit 2017 dhe 2018, dhe kanë përfshirë fusha të ndryshme si: (a) Menaxhimi i pasurisë dhe logjistikës; (b) Procedurat e Personelit; (c) Menaxhimi i kontratave; (d) Procedurat e Prokurimit; (e) Investimet Kapitale; (f) Shpenzimet e Buxhetit dhe Planifikimi; (g) Paraja Private e të Burgosurve; dhe (h) Auditim i veçantë sipas kërkesës së menaxhmentit të lartë të MD-së.

Komiteti i Auditimit (KA), kishte mbajtur katër (4) takime, ku kishte shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së, dhe raportin e auditimit të PFV-ve të MD-së të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve nuk ishte i kënaqshëm.

Çështja B6 - Rekomandimet e NjAB-së vetëm pjesërisht të zbatuara

Gjetja

Ne kemi vlerësuar se si po zbatohen rekomandimet e NjAB nga menaxhmenti i Ministrisë. Po ashtu, sipas udhëzimit administrativ nr 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Ne kemi vlerësuar se rekomandimet e NjAB ishin zbatuar vetëm pjesërisht. Këtë e konfirmon edhe Raporti vjetor i NjAB i dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Në këtë raport potencohet se nga gjithsej 19 rekomandime të dhëna, pesë (5) ishin zbatuar, 10 ishin në proces të zbatimit dhe katër (4) nuk ishin zbatuar fare.

Shkaku i mos zbatimit të rekomandimeve në nivelin e duhur është angazhimi jo i mjaftueshëm i menaxhmentit si dhe mungesa e monitorimit formal të zbatimit të rekomandimeve.

Rreziku

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të NjAB rritë rrezikun e përsëritjes së gabimeve dhe mangësive të identifikuara në funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Rekomandimi B6 Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Ndonëse janë zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk kanë dhënë përgjigje efektive dhe me kohë ndaj disa problemeve operative të identifikuara. MD ka dizajnuar sisteme relativisht të mira të kontrollit të brendshëm⁵ dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies.

MD ka plotësuar kërkesat e MFK-së duke e hartuar matricën e rreziqeve të mundshme, ku janë përfshirë: identifikimi, vlerësimi, trajtimi i rreziqeve, si dhe analizimi dhe raportimi përfundimtar mbi sistemin e menaxhimit vjetor të rreziqeve. Janë përcaktuar edhe llojet, gjasat e ndodhjes së rreziqeve, veprimet që do të ndërmerren nga departamentet përkatëse dhe afatet brenda të cilave do të bëhet monitorimi tyre, dhe për vitin 2018 ishte bërë edhe monitorimi në baza tre mujore i kësaj matrice.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 kishte rezultuar në 14 rekomandime. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar; katër (4) ishin në proces dhe katër (4) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

⁵ Për qëllime të auditimit të PVF-ve, ne nuk kemi arritur të marrim mbështetje në kontrollet e brendshme për shkak se ato nuk i kanë adresuar plotësisht pohimet e auditimit

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ti eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontigjente dhe për ta konfirmuar vlerësimin dhe shpalosjen e saktë të pasurive jokapitale. Në këtë drejtim, departamentit të financave duhet ti ofrohen shënimet e sakta rreth detyrimeve kontigjente. Njëkohësisht departamenti i financave duhet ti analizojë mirë shënimet, para se ato të shpalosen në PFV.</p> <p>Po ashtu, Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga Zytari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha e nevojshme.</p>	Menaxhmenti kishte bërë përpjekje për përmirësimin e menaxhimit të pasurive, duke kërkuar në vazhdimësi ndihmë nga MAP-i që ta funksionalizojë sistemin e e-pasuria, por edhe më tutje regjistrat e pasurive nën 1,000€ dhe vlerat e pasurive të prezantuara në PFV nuk janë të sakta dhe të plota.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Procesi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike, në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar, me fokus të veçantë në projektet kapitale	Realizimi i buxhetit tek investimet kapitale ishte në nivelin optimal. Mbi 90% e buxhetit janë shpenzuar në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar.
3	Të hyrat	Ministri nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së duhet të sigurojnë që zyrtarët përkatës të cilët janë të ngarkuar me menaxhimin e parave të të burgosurve, me rastin e përfundimit të dënimeve, secilit person të liruar nga burgu t'ia kthejnë mjetet të cilat i kanë në depozitë.	Menaxhmenti në qershor 2018 kishte nxjerrë rregulloren e re për paratë e burgosurve e cila menjëherë ka filluar të	Rekomandim i zbatuar.

			jep rezultate. Prandaj rekomandimi konsiderohet si i zbatuar	
4	Pagat dhe shtesat	Ministri duhet të sigurojnë respektimin e plotë të dispozitave ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga të gjithë vartësit e tij. Në rastin konkret kontratat e nëpunësve civil duhet të zëvendësohen me aktemërimë, dhe pagesat e shtesave të bëhen konform vendimeve në fuqi. Ndërkohë shtesat e stafit të teknologjisë informative duhet të paguhen në pajtim me vendimet në fuqi.	Kontratat e nënunjësve në fjalë janë zëvendësuar me aktemërimë si dhe shtesat tani paguhen në pajtim me vendimet.	Rekomandim i zbatuar.
5	Menaxhimi i Personelit	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime konkrete për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me UD. Të rishikohen arsyet e mos angazhimit të personelit të rregullt në këto pozita dhe të vendosen kontrole shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre nuk duhet të jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.	Menaxhment për shkaqet që janë paraqitur më lartë në këtë raport, nuk kishte arritur ta zbatojë këtë rekomandim.	Rekomandim i mbylluri pa zbatuar
6	Mallra dhe Shërbime	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së duhet të sigurojnë funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontroleve financiare për kryerjen e pagesave brenda afatit të paraparë ligjorë, si dhe të bëjnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.	Menaxhmenti nuk kishte marrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim.	Rekomandim i pa zbatuar.
7	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë që është bërë aprovimi i rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.	Menaxhmenti kishte aprovuar rregullat e brendshme për menaxhim të pasurive ashtu si është rekomanduar.	Rekomandim i zbatuar.
8	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare ta kryej punën në pajtim me rregulloren duke përfshinë dhe vlerësuar të gjithë pasurinë e Ministrisë.	Edhe pse ka çështje të ngritura tek menaxhimi i pasurive nën	Rekomandim i zbatuar.

			1,000€, komisioni e ka kryer inventarizimin në pajtim me kërkesat ligjore prandaj rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	
9	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të promovojë mekanizma shtesë për të siguruar që të gjitha faturat e pranuar do të procedohen për pagesë brenda afatit të paraparë ligjor, dhe të vendosë kontrole efikase sa i përket identifikimit, regjistrimit, procedimit të pagesave dhe raportimit të detyrimeve të papaguara.	Nuk kishte ndërmarrë veprime për ta implementuar këtë rekomandim.	Rekomandim i pa zbatuar.
10	Detyrimet Kontigjente	Ministri duhet të inicojë një rishikim të funksionimit të databazës aktuale, për të përcaktuar shkaqet e mosfunksionimit efikas të saj, dhe njëkohësisht duhet të ndërmerren masat e nevojshme që menaxhimi i informatave në fjalë të përmirësohet. Kjo do të mundësonte që Ministri dhe Avokatura Shtetërore të kenë informatat e sakta në lidhje me rastet që i përfaqësojnë, dhe njëkohësisht ju ndihmon OB-ve që ti kenë informatat e sakta në lidhje me detyrimet kontigjente. Përveq kësaj Ministri duhet të rishikojë formën aktuale të komunikimit të Avokaturës Shtetërore me Institucionet që ajo i përfaqëson, dhe të nxisë një bashkëpunim më të afërt dhe efikas, në mënyrë që palët ti kenë informatat në kohën e duhur në lidhje me kontestet dhe paditë.	Nuk kishte ndërmarrë veprime për ta implementuar këtë rekomandim.	Rekomandim i pa zbatuar.
11	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Menaxhmenti kishte bërë përpjekje që ti adresoj rekomandimet tona, por edhe më tutje duhet të këtë angazhim në mënyrë që të zbatohen plotësisht.	Rekomandim i mbyllur pjesërisht i zbatuar.

12	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për të inkurajuar menaxhmentin dhe njësitë administrative që ti zbatojnë rekomandimet e NjAB-së, në mënyrë që të përmirësohen fushat ku janë identifikuar mangësi.	Nuk kishte ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim.	Rekomandi m pjesërisht i zbatuar.
13	Raportimi menaxherial, llogaridhëni a dhe menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të siguroj që lista e rreziqeve të monitorohet në vazhdimësi, në baza tremujore, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, si dhe të merren masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Nuk kishte ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim.	Rekomandi m pjesërisht i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontingjente dhe për ta konfirmuar vlerësimin dhe shpалosjen e saktë të pasurive jokapitale në PFV-të e vitit 2019.		
2	Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha njësitë organizative mbajnë evidenca dhe raporte të sakta në lidhje me shpenzimet e ndodhura në secilën njësi/qendër të paraburgimit, në mënyrë që buxheti të përgatitet dhe shpenzohet sipas planifikimeve fillestare.		
3	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri, për të eliminuar mundësinë e pagesës së dyfishtë të faturave, duhet të forcoj disiplinën financiare të personave përgjegjës dhe të siguroj që me një urdhërpagesë të paguhet vetëm një faturë, në mënyrë që të ketë kontroll të plotë dhe informata të sakta mbi pagesën e faturave.		
4	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të siguroj funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.		
5	Mallrat shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të kenë njohuritë/trajnimet e nevojshme në lidhje me menaxhimin e kontratave, si dhe të bëjnë një monitorim të vazhdueshëm të kontratave që nga momenti i nënshkrimit deri në përfundimin e kontratës në të gjitha elementet e saj.		
6	Investimet kapitale	Ministri duhet të vendos kontrollet e duhura në ndarjen e detyrave dhe të eliminoj mundësinë që personat e njëjtë të kryejnë nga disa funksione, sepse të njëjtat mund të rezultojnë me konflikte interesash.		
7	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se do të aplikohen kushtet e garancionit të shërbimeve dhe furnizimeve konform kontratave të nënshkruara.		

8	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri të siguroj që çështja e menaxhimit të regjistrave të pasurisë të përmirësohet para mbylljes së vitit aktual fiskal, në mënyrë që në PFV-të e vitit 2019, pasuria të jetë e prezantuar me vlerën e saktë. Si pikënisje duhet të merren raportet e inventarizimit të pasurive për vitin 2018 dhe barazimet me regjistrin kontabël.
9	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se të gjitha aktivitetet operative të ministrisë janë të buxhetuara dhe të forcoj disiplinën financiare që të gjitha obligimet e konfirmuara, të kryhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.
10	Detyrimet Kontigjente	Ministri duhet të konsiderojë mundësinë e rritjes së kapaciteteve njerëzore të Avokaturës Shtetërore dhe përmirësimit të kushteve për punë, si dhe të inicioj një rishikim të funksionimit të data bazës aktuale, për të përcaktuar shkaqet e mosfunksionimit efikas të saj, dhe njëkohësisht duhet të ndërmerren masat e nevojshme që plotësimi dhe menaxhimi i informatave të organizatave buxhetore të përmirësohet.
11	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES/VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br:No: 02-612

Data/Datum/Date: 17 / 04 / 2019

Shtojca/Dodaci/Annex: -1-

PRISHTINË



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE/DATE/DATE RECEIVED/SUBMITTED: 17.04.2019

Nr. Org. / Org. Unit	Shif. Klasif. / Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot. Prot. No.	Rr. faqeve / Br. Stranica No. Pages
<u>03</u>	<u>47</u>	<u>459</u>	<u>1</u>

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit si dhe pas takimit me Drejtorët e Agjencioneve janë pajtuar me të dhënat dhe rekomandimet, kështu që nuk kanë ndonjë koment.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

Data: 15 prill 2019, Prishtinë

Qemajl Marmullakaj
 Sekretar i Përgjithshëm

